



UNIVERSITETI I PUBLIK "KADRI ZEKA"

Zija Shemsiu, 60000, Gjiilan, Kosovë
www.uni-gjiilan.net tel: 0280390112

Rektori
Prof. Dr. Bajram Kosumi

Për: Familjen Hoxha

Lënda: Letër ngushëllimi

E nderuara Familje Hoxha,

Me pikëllim të thellë morëm lajmin për ndarjen nga jeta të më të dashurës suaj, studentes sonë, Arta Hoxha.

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, ndanë dhimbjen me familjen dhe kolegët, për humbjen e parakohshme të studentes së Fakultetit Juridik Arta Hoxha.

Kjo humbje e madhe, la në gjysmë ëndrrën e saj për rrugëtimin që kishte nisur Arta në fushën e drejtësisë.

Arta do të mbetet në mendjen dhe kujtesën tonë, si vajzë e zgjuar dhe studente e dalluar, me të gjitha tiparet që duhet të ndjekin kolegët e saj.

Universiteti Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan, në këto momente të vështira për Familjen Hoxha, për të afërmit dhe kolegët e Artës, u qëndrojmë pranë duke ndarë dhimbjen me Ju.

Ju lutem që emër të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan dhe në emër timin, t'i pranoni ngushëllimet më të sinqerta.

Me respekt

Prof. Dr. Bajram Kosumi
Rektor i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjiilan

Gjiilan, më 18 mars 2022